



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 10, datë 30.04.2025

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT PËRMBLEDHËS TË BASHKIMIT TË
OPERATORËVE EKONOMIKË “DELOITTE AUDIT ALBANIA” SHPK DHE
“DELOITTE ALBANIA” SHPK PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR PERIUDHËN 2021 - 2024”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1 dhe pika 4 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 17 të Rregullores “Për kartën e auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 16, datë 30.04.2020, të ndryshuar, si dhe të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, me propozim të Audituesit të Brendshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit përmbledhës të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k. dhe “Deloitte Albania” sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Agjencisë të Sigurimit të Depozitave, për periudhën 2021 - 2024”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

